



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

## RREGULLORE

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT  
NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË  
“BACHELOR”  
NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,  
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE  
PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025**

MIRATUAR ME VENDIM NR 15, DATË 09 / 02 / 2023  
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74, Pranimi në ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të parë të studimeve "Bachelor", konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2024-2025 do të zhvillohen si më poshtë:

### **Neni 1** **Pranimi i kandidatëve**

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhet me konkurs. Rezultati me pikë i konkurseve të pranimit që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj Rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve sëbashku me rezultatet me pikët e Maturës Shtetërore përbëjnë rezultatin përfundimtar.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Pikët e vlerësimit për çdo konkurrent do të ndahen sipas vendimeve të Senatit Akademik dhe Udhëzimeve të MAS.

### **Neni 2** **Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit**

- 2.1 Dekani i Fakultetit merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 2.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 2.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
  - I. Titullarë të fushës përkatëse,
  - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
  - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 2.4 Në përbërje të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 2.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik.
- 2.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron zhvillimi e të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Artit Skenik. Po ashtu konkursi monitorohet dhe nga përfaqësuesit e MAS.

**Neni 3**  
**Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.**

- 3.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit Sportit.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, të përcaktuara për këtë qëllim nga Dekani i Fakultetit.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
  - I. *Kartë Identiteti,*
  - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
  - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 3.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të paraqesë në hyrje edhe mandat pagesën e bërë në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 3.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik. Ky kalendar shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e komisioneve përkatëse.
- 3.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve gjatë konkurrimit.

**Neni 4**

**Kriteret e konkursit të pranimit për ciklin e pare Bachelor**

**Programi i Studimit: AKTRIM**

Kandidatët e Programit të Studimit Aktrim duhet të interpretojnë përpara komisionit të pranimit materialet e mëposhtme:

1. Tregim
2. Poezi

3. Monolog (i zgjedhur nga vetë kandidati konkurues)
4. Monolog nga dramaturgjia klasike botërore si Rasin, Kornej, Molier, Shekspir etj. (i detyruar)
5. Një fabul ose anekdotë
6. Bashkëbisedim mbi njohuritë e letërsisë dhe teatrit shqiptar dhe botëror.
7. Bashkëbisedim mbi njohuritë e kinematografisë shqiptare dhe botërore.

(Koha në dispozicion për paraqitjen e materialeve të kandidatit për student është 30 min.)

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Aktrim është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

### **Programi i Studimit: REGJI**

Gjatë zhvillimit të konkursit kandidatit i kërkohet nga komisioni i pranimit:

- Hartimi i një **skicë platforme regjisoriale** mbi bazën e një pjesë dramatike që caktohet aty për aty nga komisioni (tema, *konflikti, personazhet, dekori, imazhi regjisorial etj.*)
- Bashkëbisedimi mbi **formimin e përgjithshëm kulturor** në fushën e teatrit, dramaturgjisë, filmit, letërsisë në përgjithësi, arteve figurative etj. (Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

Interpretimi i materialeve të mëposhtme:

- a) **Monolog**
- b) **Tregim**
- c) **Poezi**

(Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

**Etydin regjisorial** mbi bazën e një teme të caktuar që sugjerohet aty për aty nga komisioni.

(Koha në dispozicion të kandidatëve është 5 orë, një ditë.)

### **Konkursi në programin e studimit regji zhvillohet deri në tre ditë.**

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Regji është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Gjithashtu kandidati i nënshtrohet edhe kërkesave të tjera plotësuese që jepen nga komisioni i pranimit.

### **Programi i Studimit: SKENOGRAFI – KOSTUMOGRAFI**

Kandidati duhet t'i nënshtrohet këtyre kërkesave:

- Realizimi i një modeli të kompozuar nga natyra në vizatim ose pikturë. (koha: 5 orë, një ditë.)

- Krijimi i një projekti skenografik ose kostumografik. (koha: 5 orë.)
- Testimi teorik me shkrim mbi formimin e përgjithshëm kulturor dhe profesional në fushën e teatrit, letërsisë dhe muzikës (në formimin profesional duhet të ketë njohuri teorike për specifikën e skenografisë, kostumografisë, pikturës, vizatimit dhe Historisë së Arteve Figurative.) (koha: 45 minuta.)

Konkurenti duhet të paraqesë dosjen personale e cila duhet të ketë kompozime në skenografi, kostumografi, pikturë, vizatim etj. Dosja dorëzohet ditën e fundit të konkursit, mbi të cilën do të bëhet bashkëbisedimi me komisionin. (koha: 30 minuta.)

**Konkursi në programin e studimit skenografi-kostumografi zhvillohet në tre ditë.**

**SHËNIM: Telajot, letrat, bojrat do të përballohen nga vetë kandidati.**

### **Programi i Studimit: KOREOGRAFI**

Konkursi do të zhvillohet me një fazë dhe do të ketë këto kërkesa:

- Ushtrime klasike, (klasë baleti). (koha: 90 minuta)
- Demonstrim i një variacioni nga baletet e ndryshme botërore dhe shqiptare. (koha:90 minuta)
- Kompozim nga kandidati për ndërtimin e një motivi klasik si dhe popullor me ritme 2/4; 3/4; dhe ritme të përziera. (koha: 60 minuta) **(një ditë)**
- Ekzekutimi i një pantomime sipas kërkesës së komisionit. (koha: 60 minuta)
- Përgatitja e një libreti koreografik dhe demonstrimi i gjuhës shprehëse të personazheve (Tema jepet nga komisioni). (koha: 260 minuta, një ditë)
- Bashkëbisedim rreth njohurive teorike e praktike mbi Folklorin Koreografik Shqiptar. (koha: 60 minuta)
- Bashkëbisedim rreth njohurive mbi Historinë e Baletit Shqiptar dhe Botëror. (koha: 60 minuta) **(një ditë)**

**Konkursi në programin e studimit koreografi zhvillohet në tre ditë.**

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit Koreografi është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

### **Programi i Studimit: REGJI FILMI DHE TV**

Kandidatët për këtë specialitet duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Hartimin e një skicë – platforme regjisoriale në bazë të një tregimi, novele apo historie të shkurtër që caktohet aty për aty nga komisioni pranues. (tema, *konflikti, karakteret, skenografia, imazhi regjisorial*) (koha: 240 minuta)

- Bashkëbisedim mbi formimin kulturor në fushën e kinematografisë shqiptare dhe botërore, zhanret e filmit, letërsisë në përgjithësi, muzikës, artet figurative etj. (koha: 60 minuta,) **(një ditë)**
- Njohuri për përdorimin e aparatit fotografik me film. (si *opsion mund të jetë dhe aparati digital*) (koha: 300 minuta, **një ditë**)
- Etydin regjisorial mbi baza fotografie të një teme që sugjerohet nga komisioni aty për aty. (koha: 300 minuta) **(një ditë)**

**Konkursi në programin e studimit regji filmi dhe televizioni zhvillohet në tre ditë.**

Koha e zgjatjes së konkurimit në programin e studimit regji filmi dhe televizioni është në varësi të numrit të kandidatëve pjesëmarrës.

Kandidati duhet të disponojë gjatë zhvillimit të konkursit një aparat fotografik.

**SHËNIM: Të gjithë të interesuarit për sqarime të mëtejshme të paraqiten pranë Sekretarisë së Fakultetit**

**Neni 5**

**Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve**

- 5.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohet nga Dekani i Fakultetit.
- 5.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 5.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkurrin kërkesa konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 5.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 5.5 Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 5.6 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 5.7 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 5.8 Komisionet e Programeve të Studimit në Fakultetin e Artit Skenik për mbarëvajtjen e konkursit marrin edhe këto masa:

**a) Aktrim**

Për secilin kandidat Komisioni i Pranimit të programit të studimit Aktrim xhiron me kamera njërin prej materialeve që e gjykon të arsyeshëm.

**b) Regji**

Komisioni depoziton në një dosje të veçantë platformën regjisoriale të gjithë kandidatëve për programin e studimit Regji. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve për secilin kandidat. Materialin e përcakton komisioni.

**c) Skenografi – Kostumografi**

Komisioni depoziton punimet e kryera gjatë ditëve të konkursit së bashku me dosjet personale për secilin kandidat për programin e studimit Skenografi & Kostumografi. Po ashtu depoziton në një dosje të veçantë testin teorik për secilin kandidat të sekretuar.

Në këtë specialitet komisioni e fillon punën e tij pas përfundimit të procesit të konkursit të konkurrentëve.

**d) Regji Filmi dhe TV**

Komisioni depoziton në një dosje të veçantë etydin regjisorial mbi baza fotografie për secilin kandidat për programin e studimit Regji Filmi dhe TV. Po ashtu depoziton në këtë dosje edhe platformën regjisoriale nga secilin kandidat gjatë konkurrimit.

**e) Koreografi**

Komisioni depoziton në një dosje të veçantë libretin koreografik të kandidatëve për programin e studimit Koreografi. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve koreografike që komisioni e gjykon të arsyeshëm për secilin kandidat.

- 5.9 Komisionet e Pranimit të Programeve të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal sekretarisë së Fakultetit.
- 5.10 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmoset nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

**Neni 6**  
**Shpallja e fituesve**

- 6.1 Shpalljen e listës së renditjes provizore të rezultateve për konkursin e pranimeve për të gjitha programet e studimit të fakultetit e bën Dekani i Fakultetit.
- 6.2 Shpallja e fituesve bëhet duke u bazuar në Udhëzimin e MAS për zhvillimin e konkurseve të pranimit.

**Neni 7**  
**Regjistrimi për të fituar statusin e studentit**

- 7.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 7.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**. Materialet që duhet të paraqiten duhet të jenë në varësi të Udhëzimeve të MAS.
- 7.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 7.4 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç' regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.

- 7.5 Kandidatit që çregjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 7.6 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit.

**Neni 8**  
**Rregulla për kandidatët**

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 8.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 8.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit.
- 8.3 Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 8.4 Nëse ka kandidatë që konkurrojnë në dy ose më shumë programe studimi dhe konkursi zhvillohet në të njëjtën kohë atëherë kandidati paraqet një kërkesë me shkrim te dekani i fakultetit për t'i mundësuar paraqitjen në të gjitha konkurrimet. Për këtë dekani koordinon punën me kryetarët e komisioneve dhe kandidatit i krijohet mundësia e paraqitjes në konkurs në kohë të ndryshme.
- 8.5 Kandidati duhet të shpërfaqë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.
- 8.6 Nuk lejohet përdorimi i celularëve apo objekti tjetër pa miratimin e komisionit.
- 8.7 Nga ana tjetër komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 8.8 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI  
**Prof. Gazmend GJOKA**

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI, KOREOGRAFI  
**Prof.asoc.Taulant PUSTINA**

DEPARTAMENTI REGJI, REGJI FILMI DHE TELEVISIONI  
**Prof.asoc. Alert ÇELOALIAJ**

ZV/DEKANI TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK  
**Prof. Ilir MARTINI**

**DEKANI**  
**Prof. Petrit MALAJ**

